REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr3408 Prot Maliq, më 01.06.2026

VENDIM

Nr.73, datë 29.05.2026

"PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE PRIVATE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "PALLATI I KULTURËS "DHIMITËR ORGOCKA"

Në mbështetje të të ligjit nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2 gërma b dhe c, nenit 23, pika 7, nenin 54, nenin 55 pika 2 dhe 6, ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik"*, i ndryshuar, projektit të hartuar nga Sektori i Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, për objektin *"Pallati i Kulturës "Dhimitër Orgocka"* Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Fillimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Pallati i Kulturës "Dhimitër Orgocka"sipas listës së pasurive, planeve të rilevimit dhe projektit që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Sektori i Pronave Publike dhe Aseteve, të kryeje verifikimet e dokumentacionit ligjor (statusit juridik) pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të pasurive që preken nga zbatimi i projektit, si dhe të vijojë procedurat e metejshme të përgatitjes së dokumentacionit të plotë që nevojitet për shpronësim për interes publik dhe dërgimin e kërkesës zyrtare pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, Tiranë.
3. Për zbatim ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 18 vota
Vota Pro 18
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 01.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ